



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 487/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prishtinë.

Arsyetim

Me datën 04.11.2013, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se më datë 03.11.2013 në Qendrën e Votimit nr. 2003A në Ortakoll, pretendohet se sekretari i degës së PDK-së në Prizren Njhazi Kryeziu, dhe njëherit kandidat për asamble komunale në Prizren ka bërë presion tek votuesit. Veprimi i tillë është në kundërshtim me, nenin 34.2 si dhe Kodit të Mirësjelljes për Subjekteve Politike të LKP-së thuhet në ankesë.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë prove apo dëshmitar të rastit.

Në përgjigjen e datës 07.11.2013 të ofruar në PZAP nga Policia e Kosovës 2013-1-1262 theksohet se për rastin në fjalë të ankesës të LDK-së thotë se nuk kemi shënime për to pasi që për te njëjtën ankesë kemi kontaktuar edhe me zyrtaret e LDK-së z. Nderim Gashin dhe z.Valdet Hoxha, zyrtar juridik për ankesa pranë këtij subjektit politik, dhe te njëjtat njoftuan se te gjitha shënimet që kemi pasur i kemi percjellur tek zyret e PZAP- it dhe nuk posedojmë asnjë shënim më shume as me pak lidhur me ankesat te cilat i posedon PZAP- i.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apeloohen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”.*

PZAP-i konstatoi se pretendimet e subjektit politik LDK nuk qëndrojnë ngase në shkresat e lëndës nuk ka bashkangjitur asnjë provë bindëse apo nuk ka dhënë ndonjë emër të ndonjë dëshmitari të ngjarjes për të cilën pretendohet, që mund te vërtetohet shkëlqen e supozuar, kjo vërtetohet edhe përmes raportit të policisë me nr.2013-1-1262 të datës 07.11.2013.

Andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 487/2013 më datën 07.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.